



**FRIEDRICH NAUMANN  
FOUNDATION** For Freedom.

Western Balkans



**Valdrin Lluka**

# **NDIKIMI I PANDEMISË COVID 19 NË EKONOMINË E KOSOVËS**

[freiheit.org](https://freiheit.org)

# Për botuesin

## **Autori**

Valdrin Lluka

## **Redaktoi**

Michael Roick & Dr. Minire Çitaku

## **Dizajni dhe Printimi**

KATËR AGENCY

## **Numri i kopjeve**

50

## **Botues**

Friedrich Naumann Foundation for Freedom  
Western Balkans  
Bulevar kneza Aleksandra Karadjordjevica 13/A8,  
11000 Belgrade, Serbia  
00 381 11 3066824  
[www.freiheit.org](http://www.freiheit.org)  
[www.freiheit.org/western-balkans](http://www.freiheit.org/western-balkans)  
[westbalkan@freiheit.org](mailto:westbalkan@freiheit.org)  
<http://westbalkan.freiheit.org>

 @FNFWesternBalkans

 @FNFWestbalkans

**Dhjetor 2020.**

**E drejta e autorit © nga  
Fondacioni Friedrich Naumann  
për Liri.**

**Të gjitha të drejtat e rezervuara**

Ky artikull pasqyron mendimin e autorit dhe jo domosdoshmërisht pozicionin e Fondacionit Friedrich Naumann për Liri!

# Përmbajtja

|                                                     |    |
|-----------------------------------------------------|----|
| Parathënie                                          | 2  |
| Ndikimi i pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës | 4  |
| Masat e marra nga qeveria                           | 8  |
| Masat e arsyeshme për të tejkaluar krizën           | 11 |
| Politika e tatimeve                                 | 14 |
| Investimet                                          | 14 |
| Përmbledhje                                         | 18 |

# Parathënie

Kriza e Koronës e ka mbajtur botën të mbyllur për një vit të mirë tani.

Një virus shumë ngjitet - i minimizuar fillimisht në shumë vende - u zhvillua me shpejtësi në një pandemi globale, duke zhytur shoqëritë dhe ekonomitë e tyre në kriza të thella dhe duke i detyruar ata të bënin kufizime dhe shkurtime të gjera.

Prodhimi i papritur i shpejtë i vaksinave efektive ka sjellë kontrollin dhe - me shpresë - menaxhimin e kësaj pandemie brenda mundësive. Sidoqoftë, sfidat për shtetin, ekonominë dhe shoqërinë janë dhe do të mbesin të mëdha. Tashmë është e qartë se ndikimi i kësaj krize shkon më thellë sesa kriza financiare e 2008/09.

Qeverive u është dashur të marrin borxhe të konsiderueshme shtesë për të mirëmbajtur strukturat - veçanërisht në sistemin e kujdesit shëndetësor - për të siguruar ndihmë tejkalimi tejkaluese dhe për të mbështetur financiarisht kompanitë.

Ky punim, "Ndikimi i COVID-19 në Ekonominë e Kosovës", ofron një përmbledhje të hollësishme të zhvillimit të ekonomisë kosovare gjatë pandemisë, masat e marra nga qeveria për të përmbajtur frenuar ose menaxhuar krizën, dhe është një vlerësim nga një perspektivë liberale - që është e qartë e poashtu edhe e mirë bazuar sa më e qartë, aq edhe e bazuar, dhe karakterizohet nga një ekspertizë e veçantë.

Vetë autori ishte Minister për Zhvillimin Ekonomik në vendin e tij deri në fillim të vitit 2020.

Ai vëren: "Çelësi i stabilitetit në kohë pandemie është veprimi i shpejtë".

Dhe ishte pikërisht kjo që mungonte: masat u iniciuan shumë vonë, ligjet dhe paketat e urgjencës u miratuan shumë vonë.

Për më tepër, kushtet e kornizës strukture-kontekstit politike ishin gjithçka përveç optimale. Kosova kishte një suksesion ndërrim të tre qeverive vitin e kaluar dhe rrjedhimisht politikat qeveritare ishin më shumë drejt masave populiste sesa të qëndrueshme.

Sidoqoftë, autori mbetet gjithmonë i drejtë paanshem në vlerësimet dhe propozimet e tij, dhe kështu i gjithë teksti bëhet një shembull kryesor i analizës serioze që meriton të lexohet gjerësisht.

## Michael Roick

Shef i Zyrës së Ballkanit Perëndimor  
Friedrich-Naumann-Fondacioni për Liri



# Ndikimi i Pandemisë Covid 19 Në Ekonominë E Kosovës

Implikimet ekonomike të COVID19 në Kosovë kanë shkaktuar probleme në shumë sektorë të biznesit si dhe në shumë fusha të jetës. Me fillimin e pandemisë në muajin mars, Kosova sikurse edhe në vendet e tjera të rajonit, ndërmorën masa të ashpra duke e ndaluar tërësisht sektorin privat për pothuaj se dy muaj. Këto masa ishin të arsyeshme në kohën që u morën sepse alternativa tjetër do të zinte sistemin shëndetësor të papërgatitur dhe të stërngarkuar me pacientët e COVID 19. Kjo do të kishte një çmim të lartë me jetë të njerëzve.

Sipas Bankës Botërore, pritet që Kosova të ketë rritje negative prej 8.8% në vitin 2020, ku ndikimin më të madh ka pasur rënia shërbimeve eksportuese, investimeve dhe konsumi i përgjithshëm i shtyrë nga diaspora. Një rënie më e madhe ekonomike u parandalua me rritjen e remitancave nga diaspora dhe eksporti i metaleve bazë që është duke shënuar rritje të vazhdueshme.<sup>1</sup>

Rritja ekonomike e Kosovës për 4.4% në vitin 2019 dhe rritja e ngjashme edhe në vitet paraprake, ka qenë e bazuar në konsum dhe shpenzimet publike. Përderisa shpenzimet publike janë goditur për shkak të mbledhje së ulët të tatimeve nga mos-aktiviteti i bizneseve, konsumi ka pasur ndikim më të ulët disa arsye. Para së gjithash, kontribuuesi më i madh i konsumit janë pagat e sektorit publik ku këto paraqesin pothuaj se 30% të totalit të vendeve të punës në Kosovë që vijnë nga ky sektor ku edhe pagat janë në masë të konsideruar më të larta se sa paga mesatare në sektorin privat.

Në vitin 2017 paga mesatare në sektorin privat ka qenë 348 euro në muaj ndërsaq në sektorin publik 493 euro në muaj.<sup>2</sup> Pagat e sektorit publik nuk janë ndalur dhe u janë dhënë të gjithë shërbyesve publik.

Një kontribuues tjetër shtesë në konsum është diaspora, me remitancat gjithnjë në rritje, që janë futur në ekonomi për çdo vit. Duke ju falënderuar ekonomive të forta ku gjendet shumica e diasporës kosovare si Gjermania dhe Zvicra në vitin 2020 Kosova pati një rritje prej 13% të remitancave krahasuar me vitin 2019. Kjo erdhi si përgjigje e rritjes së papunësisë së shkaktuar nga pandemia dhe totali arriti shifrën 900 milion euro ose 13% të BPV-së dhe ka mbajtur kërkesën agregate të qëndrueshme.

Deri sa konsumi dhe shpenzimet publike janë mbajtur në shkallën e vitit 2019, Kosova ka pasur rënie të madhe në investime dhe eksport. Me një deficit të madh tregtar, eksporte të kufizuara dhe rritje të importit, efekti negativ në ekonomi ka qenë i kufizuar. Nivelet e tashme të eksportit të produkteve janë rreth 340 milion euro ndërsaq niveli i importit është në 4 miliard euro. Mirëpo, gjendja është ndryshe tek eksporti i shërbimeve. Këto kanë qenë të goditura më së rëndi ku vlera e tyre shkon në 1.7 miliard euro. Kjo përfshin turizmin e vendor, hotelet, dhe shumë qendra të thirrjeve që u shërbejnë kompanive të huaja dhe ku punësimi ka lulëzuar në 5 vitet e fundit.

<sup>1</sup> The World Bank Kosovo press release - October 22, 2020

<sup>2</sup> Radio Evropa e Lirë

2019

**EXPORT 340 milion**  
**IMPORT 4 miliard**

Rënia ekonomike e Kosovës e ka vënë nën tryzni edhe mbledhjen e tatimeve. Për të mbajtur në hap shpenzimet qeveritare dhe për të mbajtur ekonominë të angazhuar, zvogëlimi i buxhetit duhet të zëvendësohet me rritjen e borxhit publik. Fatmirësisht, Kosova ka njërin nga borxhet më të ulëta publike në Evropë me rreth 18.17% të BPV-së. Fatkeqësisht, edhe një borxh i vogël, do të rris borxhin publik si përqindje, për shkak të një ekonomie të vogël.


Rritja e shpenzimit publik, rënia e mbledhje së tatimeve dhe rënia e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, do ta detyroj qeverinë të rris borxhin publik. Eventualisht, kjo mund të qoj te ngritja e tatimeve e cila pastaj më tutje do të prek konsumatorët, sektorin privat, konkurrueshmërinë dhe të qenit tërheqës për investime të huaja të drejtpërdrejta.

Kjo do të sjell mungesa buxhetore që do të ngadalësojnë integrimin rajonal, për shkak të ngadalësimit të investimeve kapitale në rrugë, hekurudha, autostrada digjitale dhe gjithçka që ka të bëjë me këtë, duke rrezikuar më tutje bashkëpunimin dhe zhvillimin rajonal. Në një pikëpamje më pesimiste, mungesa e zhvillimit rajonal mund të krijoj më shumë probleme me imigrimin e të rinjve drejt vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat i kanë hapur dyert për punëtor me shkathtësi të ndryshme, duke e lënë rajonin me fuqi punëtorë të pakualifikuar.

Në aspektin pozitiv, pas pandemisë, shumë kompani evropiane do të shfrytëzojnë mundësinë dhe momentin të rrisin investimet dhe të bëjnë kontraktimin e jashtëm të proceseve drejt rajonit tonë, duke shfrytëzuar fuqinë e lirë punëtorë. Kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në BVP-në, jo vetëm si një investim në vete por për shkak se investimet e tilla janë të orientuara drejt eksportit dhe me këtë, do të rrisin eksportin, rrisin punësimin dhe do të mbushin buxhetin me tatime.

**18.17%**

**njëri nga borxhet më  
të ulëta publike në Evropë**







## Masat e marra nga qeveria



Realisht, masat fiskale dhe politike të ndërmarra deri më tash, fatkeqësisht kanë qenë më shumë vendime populliste se sa masa efektive për ekonominë e Kosovës. Kosova që nga shkurti i vitit 2020 ka përjetuar tri qeveri të ndryshme. Kjo ka krijuar shumë pengesa në ofrimin e një ndihme të duhur për qytetarët dhe bizneset gjatë pandemisë. Të gjitha qeveritë, nuk kanë pasur fuqi të mjaftueshme të votimit në Kuvend për të shtyrë përpara politika domethënëse që kërkojnë një masë substanciale të mjeteve për ta mbajtur ekonominë në lëvizje.

Propozimi i qeverisë së kaluar përmes pakos emergjente fiskale në marsin e vitit 2020 përfshinte shumë mekanizma për të ndihmuar ekonominë dhe qytetarët si: subvencione të drejtpërdrejta të pagave, hua të garantuara, subvencione të qirasë, qasje në financa për kompanitë e vogla dhe të mesme, shtyrje të pagimit të tatimeve dhe ristrukturim të pagesave të kredive.<sup>3</sup> Mirëpo, masat e marra me pakon emergjente fiskale ishin të kufizuara në subvencionim të drejtpërdrejt të pagave me 170 euro në muaj për dy muaj për ata që ishin të punësuar dhe me subvencionim prej 50% të shpenzimeve të qerasë për bizneset. Qeveria po ashtu u mundua që ti shtyjë bizneset që të dalin nga ekonomia e zezë duke subvencionuar për dy muaj me 204 euro në muaj të gjitha pagat për ata që ofrojnë kontrata njëvjeçare.

Banka Qendrore e Kosovës ka kontribuar duke shtyrë pagesën e kredive për të gjithë për 3 muaj, pa ndëshkime. Edhe pagesa e tatimeve është shtyrë me një praktikë të tillë.

# 50%

subvencion të shpenzimeve të qerasë për bizneset

Këto masa patën ndikim të kufizuar në rimëkëmbjen ekonomike sepse ishin subvencionime të vogla duke quar tek shumë biznese ti vuajnë pasojat dhe shumë persona të paraqiten për ndihmë sociale. Sektorët më të goditur ishin gastronomia, turizmi, produktet e eksportit dhe shitja me pakicë. Këta sektorë paraqesin sektorët që krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës në baza vjetore.

## Gastronomia, turizmi produktet e eksportit dhe shitja me pakicë.

Qeveria aktuale ka propozuar një ligj të ri për rimëkëmbje ekonomike i cili përmban një pako më të madhe të ndihmës për qytetarët dhe bizneset. Pjesët kryesore të këtij ligji janë:

<sup>3</sup> 19th government meeting - Approval of Emergency Fiscal Package

**1.**

Mundësi për qytetarët të tërheqin deri në 10% të trustit pensional,

**2.**

Krijimi i fondit që do të paguaj deri në 4 muaj pagat nga 300 euro në muaj, për të gjithë ata që kanë humbur vendet e punës për shkak të pandemisë,

**3.**

Krijimi i një fondi prej 200 milionëve për të ndihmuar bizneset me grante,

**4.**

Heqjen e TVSH-së për lëndën e parë edhe për atë që prodhohet për përdorim në tregun vendorë.

**5.**

Mbulesë ndërmjet 50% dhe 80% të kolateralit përmes fondit të garantimit të kredive, për të lehtësuar qasje në kredi për bizneset,

**6.**

Shtyrjen e pagesës së tatimit deri në dy vite dhe

**7.**

Lejim qeverisë të ketë qasje në depozitat e krijuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.<sup>4</sup>

Ky ligj është miratuar tash së voni, pas 10 tentimeve të pasuksesshme që nga korriku i vitit 2020 dhe ndikimi i tij pritet të shihet. Mirëpo, edhe pse ligji në vete është shpresëdhënës, koha e zbatimit të këtyre pagesave është shumë e kufizuar dhe kjo do ta kufizoj shumë suksesin dhe politikat e tij.

<sup>4</sup> Draft Law on Economic Recovery - Government of Kosovo



# Masat e arsyeshme për të tejkaluar krizën

## LIKUIDITETI I VEPRIMEVE TË BIZNESEVE

Ekonomia e Kosovës nuk mund të kthehet në pozitën që ka pasur në vitin 2019 duke subvencionuar vetëm pagat minimale. Pagesat e drejtpërdrejta qytetarëve edhe pse janë të mira dhe të lehta për tu zbatuar, efektet e tyre janë të kufizuara. Në kohë krizash si kjo që po kalojmë tash, bizneset kanë qenë të ekspozuara ndaj trytnisë të shkaktuar nga mungesa e klientëve. Kjo i shtyri bizneset drejt një presioni prodhues dhe të furnizimit, duke i futur në rrethin vicioz të trytnisë të kërkesës – prodhimit – furnizimit. Pasi që shumë persona ishin të obliguar të qëndrojnë në izolim, shumë kompani ndaluan pagimin e pagave, duke i lënë shumicën e qytetarëve të jetojnë me një buxhet prej 170 eurove. Këto 170 euro shkojnë vetëm për një industri, atë të ushqimit dhe eventualisht për industrinë e barërave dhe nuk përmbushin nevojat elementare të qytetarëve. Në anën tjetër, bizneset vuajnë dëmet afatgjate.

*Deri më tash, masat politike të marra nga qeveria e Kosovës nuk kanë qenë të duhura dhe nuk kanë qenë të zbatuara në interesin më të mirë të motorit ekonomik, pra sektorit privat.*

duke i lënë shumicën  
e qytetarëve të jetojnë  
me një buxhet prej

# 170€

Politikë më e favorshme do të ishte ajo ku qeveria do të garantonte hua për të gjitha bizneset që kanë treguar se janë të qëndrueshme në qarkullimin e parasë së gatshme për shpenzimet operative të shkaktuara nga pandemia sikurse që janë pagimi i pagave, shpenzimeve të energjisë ose shpenzime të tilla të ngjashme. Këto kredi do të shpërndaheshin nga bankat komerciale dhe do të garantoheshin nga Fondi i Kosovës për Garantimin e Kredive që tashmë është funksional.

**DUKE BËRË KËTË DO TË KISHTE DISA PËRFITIME SIKURSE JANË:**

# 1.

Sistemi bankar do të vazhdonte të mbetej i qëndrueshëm, i fuqishëm dhe do të zgjerohej, duke kontribuar në buxhetin e Kosovës përmes mbledhjes së tatimeve;

# 2.

Punëtorët do të merrnin pagat e tyre të plota dhe për pasojë kërkesa do të mbetej e fortë në shumë sektorë kryesor (përveç mallra luksi dhe gjëra të tilla) dhe do të kishte rritje të kursimeve për shkak të izolimit për siguri. Kursimet do të ndihmonin që të kemi një rimëkëmbje më të shpejtë të ekonomisë pas pandemisë;

# 3.

Tatimi në të hyra do të mblidhej dhe me këtë buxheti do të ndikohej në masë minimale;

# 4.

Do të forconte biznesin me pakicë online për shkak të pranisë së parasë së gatshme;

# 5.

Pasi që huat janë të kthyeshme, shumë investime kapitale nuk do të sakrifikoheshin sepse në to mund të investohej në një fazë më të vonë;

# 6.

Nuk do të kishte një papunësi kaq të madhe sikurse që është me politikat e tashme

Huat operative do të ishin për një periudhë 3 vjeçare, pa kamatë, dhe me një grace periodë prej 6 muajve; një hua e cila do të paguhej tërësisht brenda një viti do të merrte një grant me vlerë të 20% të huas. Sa më shpejtë që kthehet huaja, granti do të ishte më i lartë dhe kjo do të shtynte një sjellje të përgjegjshme.

Çmim për qeverinë do të ishte kamata, granti dhe potencialisht kreditë e këqija. Duke pasur parasysh se Kosova ka diku 30 mijë biznese aktive, i tërë investimi nuk do të kalonte 300 milion euro, nëse supozojmë se kostoja për punëtor do të caktohej për një pagë vjetore ose rreth 3500 euro.



## Politika e tatimeve

Politika fiskale ekspansive është përgjigje për situatën e tashme të krijuar nga COVID 19. Kjo sepse, Kosova përdorë euron si valutë kryesore dhe Kosova nuk ka mekanizma të politikave monetare sepse kjo do të lehtësonte barrën për ta humbur atë. Përndryshe, rritja e subvencioneve dhe zvogëlimi i tatimeve në disa fusha do ti ndihmonte sektorit privat, punësimit dhe kërkesës së përgjithshme agregate. Kosova është në një pozitë të favorshme, duke marr parasysh borxhin e ulët publik, që është diku 18.7% që nga viti i kaluar. Këtë vit ai do të ngritët pak por ende është shumë më i ulët se sa në shumicën e vendeve të Evropës.

## Investimet

Si shtesë për likuiditetin e bizneseve dhe politikave tatimore, qeveria duhet të përqendrohet në politikat afatmesme që do të ndihmonin rimëkëmbjen e shpejt të ekonomisë. Politikat e tilla duhet të përfshijnë; të qenit më konkurrues në tërheqjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja, përmirësimi në qasjen e tregjeve të reja për rritje të eksportit, zgjerimin e investimeve në energji të ripërtëritshme dhe privatizimin e asetëve kryesore publike.



# Konkurrencë e egër me Serbinë & Maqedoninë Veriore

Pas pandemisë COVID 19, mjedisi për bërje biznesi do të transferohet drejt një mekanizmi më efikas dhe me kosto më të ulët. Bizneset e Bashkimit Evropian kanë nevojë të kthehen shpejt në binarë dhe do të jetë një konkurrencë e egër se kush do të përfitoj çka në treg. Nevoja për të vepruar në një mjedis me shpenzime të vogla dhe të kontraktohen jashtë disa procese të punës, do të jetë e pashmangshme dhe rajoni më i përshtatshëm për të bizneset e BE-së është Ballkani Perëndimor.

Qeveria e Kosovës është në një konkurrencë të egër me vendet e rajonit, kryesisht me Serbinë dhe Maqedoninë Veriore edhe pse Kosova ofron njërin nga politikat tatimore më të mira dhe më të favorshme. Kosova duhet të jetë konkurruese me subvencione për të qenë në gjendje të tërheq investime të drejtpërdrejta të huaja. Për këtë arsye, një plan se si tu qasemi investitorëve të jashtëm, çka tu ofrojmë dhe si të japim subvencione, duhet të jetë pjesë e agjendës së rimëkëmbjes ekonomike.


Një rritje e investime të drejtpërdrejta të huaja do të thotë rritje e eksporteve sepse ata që investojnë në Kosovë dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, zakonisht prodhojnë dhe kryejnë shërbime për tregun evropian. Qeveria e Kosovës po ashtu duhet të parasheh stimulimin e bizneseve vendore bazuar në stimulimin e eksportit. Si shtesë e stimulimit të eksportit, edhe një program për gjetjen e tregut duhet të jetë pjesë e agjendës për rimëkëmbje ekonomike.

Kërkesa për energji është e qëndrueshme dhe në rritje. Do të ketë kapital të mjaftueshëm në dispozicion për projekte të energjisë së ripërtëritshme, si rezultat i projekteve të lëna nga sektorët tjerë dhe që u ngadalësuan gjatë pandemisë COVID 19. Qeveria e Kosovës ka kapacitetet dhe mundësinë për të rritur numrin e licencave për parqe solare dhe të erës, për të tërhequr kapitalin e jashtëm, për të gjeneruar aktivitete ekonomike dhe punësim përmes prodhimit të energjisë. Kjo po ashtu do të ndihmonte në përmbushjen e kritereve të BE-së për energji të ripërtëritshme, duke i ndihmuar rimëkëmbjes së shpejt të ekonomisë.

## Stimulim të bizneseve

Për fund, Kosova ka dy asete madhore me një ndikim të madh në ekonomi; Telekomit i Kosovës dhe miniera e Trepçës (njëra nga minierat më të mëdha në Evropë e plumbit dhe zinkut). Të dy këto asete sot janë në pronë shtetërore. Performanca e tyre është jashtëzakonisht e keqe për shkak të nepotizmit dhe ndikimit politik në to. Janë të stërngarkuara me punëtor dhe menaxhohen në mënyrë shumë joefikase.

Në anën tjetër, sektorët e telekomit dhe minierave kanë parë një rritje pozitive gjatë vitit 2020, kryesisht për shkak të rritjes së digjitalizimit të bizneseve dhe rritjes së eksportit të metaleve. Ky privatizim do të i ndihmonte Kosovës për të tërhequr kapitalin e huaj duke rritur performacën e këtyre kompanive dhe ndikimin e përgjithshëm në ekonomi.





# Përmbledhje

Edhe pse qeveria e Kosovës ka pasur një plan të mirë të rimëkëmbjes së ekonomisë në letër nuk ishte në gjendje ta zbatojë atë si duhet dhe ku pjesa më e madhe e tij ende nuk është zbatuar. Çelësi i stabilitetit në kohëra të pandemive është të veprosh shpejt. Qeveritë nëpër botë ishin të shpejta në shpërndarje të subvencioneve në para të gatshme edhe për qytetarët edhe për bizneset, me qëllimin e vetëm për të mbajtur likuiditetin e qarkullimit të parasë në ekonomi.<sup>5</sup> Ndërkaq, Kosova dështoi të miratonte ligjin për rimëkëmbjen ekonomike 10 herë radhazi dhe e kaloi atë në tentimin e 11 më 4 dhjetor 2020. Kjo legjislaturë ka paraparë një ndryshim të përkohshëm të ligjeve kryesore të ekonomisë, të cilat do të kthehen në bazën e tyre më 31 dhjetor 2020. Nëse kjo qëndron, me miratimin e ligjit për rimëkëmbjen ekonomike, qeveria e Kosovës i ka në dispozicion 26 ditë ti harxhoj 365 milion euro. Një mision i tillë është pothuajse i pamundshëm dhe do të krijoj shumë mos efikasitete gjatë shpërndarjes së fondeve dhe ajo që është më e rëndësishmja, nuk do të ketë efektin e dëshiruar në ekonomi.

Mirëpo, krijimi i mundësisë për të tërhequr 10% të trustit pensional, shpërndarja e rrogave atyre që kanë humbur vendet e punës dhe rritja e likuiditetit të bizneseve përmes huave dhe granteve të subvencionuara, do të ndihmoj në rritjen e kërkesës agregate në ekonomi dhe do të rris gradualisht shpejtësinë e mekanizmave tashmë të ngadalësuar të ekonomisë.

<sup>5</sup> [OECD - Tax and fiscal policy in response to the Coronavirus crisis](#)



Valdrin Lluka është udhëheqës me më shumë se 15 vite përvojë në sektorin publik dhe at privat, në menaxhim, konsulencë si dhe në zhvillim të lidershit. Ai aktualisht shërben si një udhëheqës ekzekutiv në Solaborate, kompani teknologjike e specializuar në hardware dhe software të telemjekësisë, tele-edukim si dhe në video-konferencë.

Lluka mbanë titullin Master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti i Minesotës "Carlson School of Management" (2007-2009) dhe ekonomist nga Universiteti Amerikan në Bullgari, (2002-2005).

Valdrin Lluka ka shërbyer si Ministër i Zhvillimit Ekonomik në Republikën e Kosovës (2017-2020), ku kishte përgjegjësi në zhvillimin e energjisë, minierave dhe sektorin e ICT dhe mbikëqyrës në të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë.

Para se të emërohej si Ministër, Lluka ka udhëhequr një zigjir të objekteve të prodhimit të ushqimeve të freskëta dhe atyre të procesurara, ku kishte punësuar më shumë se 200 punëtorë dhe 100% e produkteve exportoheshin (2015-2017). Më herët, ai ka punuar në Deloitte, Carlson Consulting Enterprise si dhe në operatorin mobil Z-Mobile (2005-2010).

Gjatë eksperiencës së tij profesionale në sektorin publik, Lluka ka demonstruar aftësi në zhvillim, implementim si dhe mbikëqyrje për aktivitete inovative në Kosovë si dhe promovimin e produkteve vendase përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), një agjenci qeveritare nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ku ai shërbeu për 4 vite si Kryeshef Ekzekutiv (2011 - 2014).

Lluka ka udhëhequr Këshillin Kombëtarë të Zonave Ekonomike dhe ka shërbyer në disa fusha të zhvillimit ekonomik brenda si dhe jashtë Kosovës.

Lluka ka shërbyer si vullnetar si bashkudhëheqës në Bordin e Fondit Kosovaro Amerikan të Edukimit, KAEF (2014-2017) si dhe aktualisht shërben anëtar i Bordit të KAEF.

KAEF është fond dedikuar në zhvillimin afatgjatë ekonomik të Kosovës përmes edukimit të qytetarëve në top universitetet Amerikane në nivelin Master. KAEF ndan deri në 8 bursa të plota për çdo vit tek kosovaret premtues për studime Master në top Universitetet e Amerikës.

Lluka është i martuar dhe ka dy fëmijë.

**Valdrin Lluka**

